

Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall vendin vakant për Kryetar i Degës së Financës pranë Institutit të Gjeoshkencave, UPT, si më poshtë:

KRITERET DHE KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT PËR KRYETARI I DEGËS SË FINANCËS NË INSTITUTIN E GJEOSHKENCAVE

1. Kriteria të veçanta që duhet të plotësojë kandidati për Kryetar i Degës së Financës në Institutin e Gjeoshkencave.

- a) Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkencat Ekonomike.
- b) Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në fushën e financës/buxhetit.
- c) Të njoh programin kompjuterik Financa 5.

2. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për Kryetar i Degës së Financës në Institutin e Gjeoshkencave.

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- b) Të jete në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- c) Të mos jetë denuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.
- d) Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.

DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **28.02.2024** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratit e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Curriculum Vitae;
3. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuar. (Aplikantët që kane kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
4. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
5. Kopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Certificate kualifikimi dhe trajnimesh të ndryshme (në rast se ka);
7. Raport mjekësor për aftësi në punë;
8. Dëshmi penaliteti ose formular vetë
9. deklarimi.